

NEKROLOGJI

PROF.DR. MUHAMET PIRRAKU**(1944-2014)**

Profesor Muhamet Pirraku u lind në fshatin Flamuras të Drenasit, më 12 tetor 1944. Shkollën fillore e mbaroi në vendlindje dhe në Bushat, Shkollën e Mesme Bujqësore e kreu në Prishtinë. Po në Prishtinë mbaroi edhe Fakultetin Filozofik - Degën e Historisë. Studimet pasuniversitare i kreu në Universitetin e Zagrebit, ku më 29 tetor 1976 magjistroi me tezën “Rinia përparimtare e Kosovës 1919-1941”. Për gjashtë muaj u specializua në fushën e historisë e të kulturës në Institutin e Romanistikës-Gjermanistikës së Universitetin e Vjenës, ndërsa më 29 dhjetor 1988 mbrojti doktoraturën, në Degën e Historisë së Universitetit të Prishtinës, me temë “Kultura shqiptare prej viteve 70 të shekullin XVIII deri në vitin 1878”.



Interesim për krijimtari letrare, Profesor Pirraku shfaqti që në shkollën e mesme, ndërkaq shkrimin e parë nga fusha e historisë së kulturës e botoi si absolvent në histori, më 7 prill 1968. Në fushë të dijes historiografike, prof. dr. Muhamet Pirraku, u bë emër i mirënjohur, me shkrime të guximshme të mbështetura në faktografi burimore. Përgatiti dhe botoi mbi 6000 zëra bibliografikë, studime, artikuj, trajtesa, recensione, kritika, e fejtone historiografike. Është autor i disa projekteve shkencore, të realizuara me përkushtim gjatë punës së tij në Degën e Historisë të Institutit Albanologjik, ku punoi që nga viti 1984 deri në pensionimin e tij më 2008.

Profesor Muhamet Pirraku botoi studimet e mëposhtme:

Kultura Kombëtare Shqiptare deri në Lidhjen e Prizrenit, Prishtinë, 1989

Historia për klasën VII (bashkautor S. Rizaj), Prishtinë, 1975.

Salih Gjukë Dukagjini: Shkrolaria e shqypes (nga osmanishtja: dr. Feti Mehdiu, mr. Mehdi Polisi), Prishtinë, 1991.

Ripushtimi jugosllav i Kosovës 1945, Prishtinë, 1992.

Kalvari i shqiptarësisë së Kosovës, Tivari 1945, Prishtinë, 1993.

Mulla Idris Gjilani dhe Mbrojtja Kombëtare e Kosovës Lindore 1941-1952, Prishtinë, 1995.

“Albania” e Konicës, Prishtinë, 1995.

Feja, kultura dhe tradita islame ndër shqiptarët (bashkautor dhe kryeredaktor), Prishtinë, 1995.

Lidhja Shqiptare “Besa-Besën” në burimet serbe 1892-1902, Prishtinë, 1996.

Lëvizja Gjithëpopullore Shqiptare për Faljen e Gjaqeve 1990-1992 (Kronikë), Prishtinë, 1998.

Për kauzën shqiptare 1997-1999, Prishtinë, 2000.

Dritë e re për kryetarin e parë të Shqipërisë Etnike (bashkautor dhe redaktor), Prishtinë, 2002.

Jo katedrale në emër të shqiptarisë së imagjinuar, Prishtinë, 2003.

Myderriz Ymer Prizreni-Ora, Zemra dhe Shpirti i Lidhjes Shqiptare 1877-1887, Prishtinë, 2003.

Arrestimet e Pjesëtarëve të TMK-së-Ç’është kjo?! (bashkautor dhe redaktor), Prishtinë, 2004.

Tivari 1945-Kalvari i Kosovës, Prishtinë, 2005.

Masakra në Burgun e Dubravës 19-24 maj 1999 (bashkautor dhe redaktor), Prishtinë 2005.

Për kauzën e UÇK-së, Prishtinë, 2006.

Për kauzën e shtetësisë së Kosovës, Prishtinë, 2008.

Adem Guta ekzemplari i patriotizmit të gjeneratës (1916-1945), Prishtinë, 2008.

Martirët e Shqipërisë Etnike nga Derë e Stak Mark Mirditës, Prishtinë, 2011.

“Hasan Prishtina - Vlerë Sublime e Kombit”, Prishtinë, 2013.

Profesor Muhamet Pirraku u dallua edhe për një veprimtari të ngjeshur në fushën politike Jeta e vuri në sprova që në moshë të re. Më 10 tetor 1960, organizoi bojkotin e parë publik kundër mësimin në gjuhën serbokroate në Shkollën e Mesme Bujqësore të Prishtinës. Bojkoti do të kurorëzohet me plotësimin e kërkesës në vijimësi, brenda viteve shkollore 1960/1962. Në nëntor të vitit 1963, ishte pjesë aktive e Lëvizjes Revolucionare të Bashkimit të Shqiptarëve të drejtuar nga Adem Demaçi. Në vitet ‘70, Pirraku i përkiste grupit të intelektualëve, i njohur si Çeta e Bajo e Çerçiz Topulli. Ishte krahu i djathtë i Ismail Dumoshit në përgatitjet e demonstratave studentore të nëntorit të 1968-s në Prishtinë e rrethinë. Përkrah Halil Alidemës e Demë Fetës, ai organizoi përpjekjen studentore kundër “Stafetës së Titos”, më 26 mars 1981, që realisht ndikoi në masivizimin e Demonstratës së 1 dhe 2 prillit 1981. Do të

përndiqet këmba-këmbës deri më 4 gusht 1981, kur do të arrestohet me motivim se ishte “organizuesi kryesor i demonstratave të prillit 1981”.

Edhe pas lirit të tij më 4 gusht 1982, veprimtari i orëve të para, Dr. Muhamet Pirraku nuk hoqi dorë nga aktiviteti politik. Sapo në Zagreb u ngrit Shoqata e të Burgosurve Politikë, në vitin 1989 themeloi simotrën e saj në Kosovë. Me krijimin e Lëvizjes Demokratike të Kosovës (LDK), mori rolin e aktivistit me përvojë për punë me masat. U zgjodh kryetar i Degës së Dytë të LDK të Prishtinës, e cila qe organizuese e referendumit për Republikën e Kosovës të 26-30 shtatorit 1991.

Profesor Muhamet Pirraku u tregua një veprimtar i zellshëm edhe në Lëvizjen për Faljen e Gjaqeve në Kosovë. Në rolin e koordinatorit të Kryesisë së Këshillit Qendror të Lëvizjes, ndikoi në zgjerimin e veprimtarisë pajtuese, proces ky që rezultoi me ndikim në kthesën vendimtare për çlirimin e shqiptarëve nga pushtuesi jugosllav. Profesor Pirraku është i vetmi veprimtar i Lëvizjes për Pajtimin Kombëtar Shqiptar, i cili për dy vite të Lëvizjes mbajti ditar për 476 ditë.

Duke punuar për një kohë të gjatë në Institutin Albanologjik, përveç projekteve të realizuara, kumtesave të paraqitura e diskutimeve të bëra në aktivitetet shkencore, në mesin e kolegëve Profesori i nderuar do të mbahet në mend edhe si një njeri i mirë, parimor, koleg i respektuar, gjithnjë i gatshëm të punojë e të bashkëpunojë me të tjerët.

Ndarja e tij nga jeta, përveçse një humbje e madhe për familjen, lë një zbrazëti të veçantë edhe në jetën e Institutit Albanologjik në Prishtinë, të cilin e konsideronte si shtëpi të dytë. Megjithatë, janë veprat e tij, tashmë pjesë e historiografisë shqiptare ato që e bëjnë profesor Muhamet Pirrakun figurë të shquar e me kontribute të rralla; është veprimtaria atdhetare që e bën atë pjesë të proceseve të historisë sonë më të re dhe janë kujtimet tona ato që e mbajnë të përhershme praninë e tij midis nesh.

Lulëzim Lajçi

Instituti Albanologjik - Prishtinë

